



**REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/  
REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA SHTIME/ OPSTINA-STIMLJE/ MUNICIPALITY OF SHTIME  
ZYRA E KRYETARIT/KANCELARIJA PREDSELDNIKA/MAYOR'S OFFICE**

Nr. i Protokollit: 02/ 672  
25.07.2023

**Procesverbal nga mbledhja publike me qytetarë e kryetarit për punën e tij në gjashtëmujorin e parë të vitit 2023**

E premte, më 30 qershori 2023

Kohëzgjatja e takimit: 15:00 – 16:30

Vendi i takimit: Salla e Kuvendit të Komunës së Shtimes

Pjesëmarrës në takim: Kryetari i Komunës, Qemajl Aliu, nënkyetari i Komunës, Faruk Beqa, i kryesuesi i Kuvendit, Adnan Ademi, drejtori i Drejtorisë për Administratë, Valon Januzi, drejtori i Drejtorisë për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi, Grejtbalb Emini, drejtoresha e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, Albana Fazliu, drejtori i Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik, Kastriot Shabani dhe drejtori i Shërbimeve Publike, Bardhyl Rushiti.

Rendi i ditës:

**Informatë për gjashtëmujorin e parë**

Këtë takim e hapi Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Shtimes, Adnan Ademi, i cili ka përshëndetur të pranishmit dhe ka falënderuar për bashkëpunimin e treguar dhe njëherit ka sqaruar rëndësinë e kësaj mbledhje publike me qytetarë.

Në vazhdim fjalën e mori kryetari i komunës së Shtimes, Qemajl Aliu, i cili për gjashtëmujorin e parë të këtij viti dha këtë informatë:

- **BUXHETI TOTAL**  
8.762.796 euro – të shpenzuara: 3.117.679 euro ose 36 %

Buxheti ndërtohet nga granti qeveritar, të hyrat vetanake dhe granti i donatorëve

- **RRITJA E SUBVENCIONEVE:**  
Thirrja për sport ka vlerën prej 44 mijë euro dhe ka përfunduar.  
Thirrja për Kulturë ka vlerën prej 6,750€ dhe është e hapur nga data 23.6.2023  
Thirrja për Rini ka vlerën pej 7000€ dhe është e hapur nga data 23.6.2023

**Shëndetësi:** 8 kërkesa janë të OJQ-ve, të cilat pas shqyrtimit nga komisioni për subvencione dhe transfere janë përfituese në vlerë prej gjithsejtë: 18 mijë €

33 kërkesa për përkrahje shëndetësore dhe për strehim/banim, të cilat pas shqyrtimit nga Komisioni për Subvencione dhe Transfere janë përfituese në vlerë prej 9,548 euro

#### **• BBITIA E NUMRIT TË BURSAVE**

- **KRIJJA E NUMRIT TE BURSAVE**  
Në qershori është shpallur konkursi për ndarjen e bursave për studentë, ku kësaj herë do të kenë mundësinë të aplikojnë për bursa edhe studentë që studiojnë jashtë vendit. Kjo u mundësua pas propozim vendimit të dërguar nga DKA në Kuvendin Komunal, me kërkesë për ndryshim të Rregullores për Ndarjen e Bursave për Studentë.

• FNTI SPECIAL

Vendimi i Qeverisë për zhvendosjen e Entit Special u miratua më datë 14 qershor.

- 30 shtëpi për familje në nevojë do të ndërtohen në bashkëpunim me Shoqatën Bamirëse "Iletimat e Ballkanit"

“Jetimat e Ballkanit” kemi nënshkruar marrëveshje bashkëfinancimi për ndërtimin e 30 shtëpive për familjet në nevojë. Komuna jonë do të participojë në vlerë 150 mijë euro. Tanimë janë verifikuar 9 familje që do tu ndërtohen këtë vit.

- Rregullimi i shtratit të Lumin "Shtimjanja" si pë takimo të vazhueshme me Ministrinë e Infrastrukturës për të filluar punimet sa më shpejt.

Jemi në takime të vazhueshme me Ministrinë e Infrastrukturës për të filluar punimet sa më sëpjet.

- Renovimi i plotë- modernizimi i Stadiumit të Qytetit dhe rritja e kapaciteteve të tij në vlerë 2 million euro

Talenti i të rinjve të Komunës sonë do të shoqërohet me mundësi më të mira infrastrukturore per dëshmmim e zhvillim të tij.

Investimi në këtë projekt që do të ndikojë në përmirësim drastik të kushteve të sportistëve e shikuesve tanë do të ketë ylerë plot 2 milionë euro.

- Nënshkrimi i memorandumit për ndërtimin e QKMF-së në vlerë 1.250.000€ Marrëveshja u nënshkrua më datë 16 mars. Ky projekt do ta përmirësojë ndjeshëm shërbimin shëndetësor për qytetarët tanë dhe gjithashtu do t'i rregullojë kushtet e punës për stafin shëndetësor. Është në process të prokurimit.

- Fillimi i punimeve për ndërtimin e "Unazës së Vogël të Qytetit" Kjo vepër që do të jetë me standardet më të mira e që do t'i përfshijë edhe shtegun për biçikleta. Është kanalet atmosferike e ndriçimin publik, do t'i lidhë rrugën "Adem Jashari" me "Anton Çeta".

- Më datë 26 qershori u hodh gurthemeli i rindërtimit të Shtabit të Rancës Në 25-vjetorin e themelimit të Shtabit të UÇK-së në Rancë, bashkë me Ministrin Mehaj, familjarë të dëshmorëve, përfaqësuesit e shoqatave të dala nga Lufta OVL e UÇK-së, veteranë invalidë të luftës e ushtarakë të FSK-së e përruruam asfaltimin e rrugës dhe vendosëm gurthemelin e Shtabit të UÇK-së në Rancë që do ta përjetësojë këtë pikë të rëndësishme luftarake të forcate të UÇK-së.

Ky investim në ruajtjen e heroizmit të paepur të ushtarëve që ishin pjesë e Shtabit të Rancës është në vlerë 125 mijë euro.

- Renovimi i plotë në vlerë 200.000€ të shkollës "Emin Duraku"

Me datë 15.03.2023 në SHMU "Emin Duraku" është përruar renovimi i shkollës nga Fondi për Eficiencë të Energjisë në vlerë të investimin prej 200.000 euro, ku ndër renovimet përfshihen: termoizolimin e shkollës, ndërrimin e dritareve dhe dyerve PVC, zëvendësimin e trupave ndriçues jo eficiente me ato LED etj. Në këtë përrurim ishin të pranishim edhe përfaqësues të Bashkimit Evropian, Bankës Botërore, ministrja e Ekonomisë së Qeverisë së Kosovës, znj. Artane Rizvanolli, drejtori i Fondit të Kosovës për Eficiencë të Energjisë etj.

- Rregullimi i rrugës te Kulla e Lirisë mbi Memorialin e Masakrës së Reçakut në vlerë 370 mijë euro – e cila do të kompletohet me infrastrukturë të plotë: asfaltim, trotuar dhe ndriqim.

- Fillimi i projektit për sistemin e ujitjes në Godanc për tokat bujqësore – 366 mijë euro  
Këtë javë i filluam punimet për ndërtimin e kanalit të kullimit të tokave bujqësore. Ky investim në vlerë 336.475 euro fillon nga Lagja e Zymberëve në Godanc të Epërm dhe përshkon hapësirat në të dyja anët e Lumit në sipërfaqe totale 215 hektarë.

- Punimet për ndërtimin e Bibliotekës dhe Arkivit të Qytetit

Punimet janë duke u zhvilluar me intesitet të lartë. Hapësirat e reja të kësaj Biblioteke që do të janë moderne dhe do t'i pasurojmë me tituj të shumtë të zhanreve të ndryshme, në shërbim të lexuesve e studentëve tanë të mrekullueshëm.

- Kabinetet shkencore të biologjisë, kimisë, fizikës, gjeografisë dhe matematikës, në shkollën fillore në Gjyrkoc në vlerë 15.500 euro

Nga marrëveshja e nënshkruar me organizatën "IOM" në bashkëfinancim me Komunën e Shtimes, përruruam kabinetin shkencor të biologjisë, kimisë, fizikës, gjeografisë dhe matematikës, në shkollën fillore në Gjyrkoc. I uruam stafin e shkollës dhe nxënësit si përfitues e praktikues të këtij projekti shkollor, që do të shërbej në avancimin dhe mësimin praktik të lëndëve shkencore.

- Furnizimi me barna esenciale në ShKSh dhe QKMF

Shtëpia e Komunitetit dhe QKMF janë furnizuar me barna esenciale për pacientët e tyre në vlerë 102 mijë e 735 euro, kontratë e domosdoshme kjo për trajtimin sa më të mirë të pacientëve.

- Vënia e gurthemelit të ndërtimit të Lapidarit të tre dëshmorëve Xhemshir Xhemshiri, Fadil Rashiti dhe Kadri Ademaj në Petrovë

Ky organizim është inicuar nga Këshili i fshatit, i cili ishte i mirëseardhur për qytetarët dhe për ne, me ç'rast Komuna e Shtimes i ka mbështetur për fillimet e punimeve për ndërtimin e Lapidarit për të nderuar e lartësuar veprën heroike të dëshmorëve.

Falenderoj Këshillin e fshatit për iniciativën, unitetin dhe kontributin e dhënë.

- Rregullimi i urës si dhe rivitalizimi i rrugëve që i lidhin Pjetërshticën, Carralevën, Zborcin dhe Godancin e Epërm në vlerë 637 mijë euro

- Ndërtimi i fazës së katërt për projektin e rregullimit të sheshit “Ahmet Shtimja”  
Është në fazën përfundimtarendërtimi i fazës së katërt për projektin e rregullimit të sheshit.  
Gjatësi 600m të ndërrimit të kubëzave  
Rregullim të plotë të ndriçimit  
Në vlerë investive 268.000€
- Funksionalizimi i çerdhes në Muzeqinë  
Gjatë këtyre muajve ka vazhduar Ndërtimi i çerdhes në fshatin Muzeqinë, ku objekti ekzistues është rEnovuar në tërësi dhe gjithashtu i është shtuar edhe një aneksë shtesë i cili tashmë ka përfunduar së ndërtuari.
  - Kanë filluar procedurat për ndërtimin e çerdhes në Godanc  
Për çerdhen në fshatin Godanc janë hapur procedurat e prokurimit nga Ministria e Arsimit dhe tashmë janë në fazën e përzgjedhjes së operatorit ekonomik, pas kësaj menjëherë do të fillojnë punimet për ndërtimin e çerdhes sipas afateve të parapara.
  - Ka përfunduar projekti për renovimin e çerdhes së vjetër në Shtime – vlera 100 mijë euro  
Projekti për Renovimit të Çerdhes së vjetër në Shtime, është në finalizim ku shumë shpejt do të dërgohet në Ministrinë e Arsimit të cilët do të udhëheqin me procedurat e prokurimit dhe mbikëqyrjen e realizimit të projektit. Ky projekt ka vlerë investive rreth 100.000 euro dhe po realizohet në kuadër të hapjes së qindra çerdheve nga qeveria e Kosovës.
  - Rihapja e QMF-së në Petrovë  
Në ditën e shënimit të rihapjes së QKMF “Vezir Bajrami” është hapur punku i QMF-së në Petrovë. Qytetarët kanë mundësi të marrin shërbime nga ora 08:00-14:00.  
Ka përfunduar projekti për renovimin e çerdhes së vjetër në Shtime – vlera 100 mijë euro  
Tanimë ka përfunduar faza e projektimit dhe më tej do të procedojmë me tenderim, ndërkaq planifikohet që çerdhja të funksionalizohet deri në fund të këtij viti.
  - Subvencionimi i 200 fermerëve me farë të misrit  
Pas përfundimit të procedurës të thirrjes publike për subvencionim të 200 fermerëve me farë të misrit u shpërndajtëm 100 thasë.
- Ndërtimi i parkut në oborrin e çerdhes “Albiona Asllani”  
Në çerdhen “Albiona Asllani” është realizuar projekti për Ndërtimin e këndit të lojërave me mbështetje financiare si donacion nga OJQ “Kukuk Kulturë”. Në realizimin e këtij projektit komuna dhe DKA ka kontribuar në akomodim dhe ushqim për rreth 25 vullnetarë që kanë punuar në këtë projekt. Përurimi i këtij këndi të lojërave është bërë me datë 02.06.2023 dhe me këtë rast DKA ka ndarë mirënjojje për organizatën në fjalë në shenjë mirënjojje për investimin e bërë.
- Anëtarësimi i Komunës në Organizatën “ALDA” – mundësi që është ofruar pas fitimit të çmimit për qeverisje të shkëlqyer  
Pas fitimit të Çmimit Evropian për Qeverisje të Shkëlqyer, pranuam zyrtarisht ftesë për t'u bërë anëtarë në organizatën ndërkombëtare ALDA.

Në punimet vjetore të Asamblesë së Përgjithshme të kësaj organizate që po zhvillohen në Bruksel, pranova solemnisht certifikatën e anëtarësimit të Komunës së Shtimes në ALDA që do të na ndihmojë në mirëqeverisje dhe progres të shërbimeve lokale.

- Ndriqimit publik në Petrovë, Vojnoc dhe Gllavicë

Në kuadër të projekteve të shumta infrastrukturore që kanë filluar dhe do të realizohen gjatë këtij viti, është edhe shtrimi i rrugës dhe trotuarit në Vojnoc dhe deri tash ndriçimi i një pjesë të këtij fshati dhe pjesa tjeter do të përfundohet në ditët e ardhshme.

Po ashtu, edhe rruga Haxhiu në fshatin Rashincë është pajisur me ndriçim publik, që e rritë sigurinë dhe e bën këtë rrugë më të shfrytëzueshme gjatë mbrëmjeve, sidomos tash dhe gjatë stinës së verës

- Rregullimi i rrugëve në toka bujqësore me zhavor në Mollopolc

Në fshatin Mollopolc, një rrugë pothuajse të pakalueshme e kemi shtruar me zhavor duke ua mundësuar fermerëve të zonës shfrytëzimin maksimal dhe njëkohësisht është bërë lidhja edhe me fshatin Dremjak.

- Pastrimi i Lumin "Shtimjanja"

E kemi filluar pastrimin e shtratit të Lumin "Shtimjanja" që e përshkon qendrën e Komunës sonë. E Krahas largimit të mbeturinave dhe mirëmbajtjes së vazhdueshme, do të rregullohet edhe pjesa e shtratit të Lumin në tërë gjatësinë e tij, projekt ky në vlerë 5.5 milionë euro.

Largimi i mbeturinave do të ndikojë në cilësinë e ujit që do t'i japë edhe pamje estetike më të madhe qendrës së Shtimes tonë.

Po ashtu, apelojmë tek të gjithë qytetarët që jetojnë pranë Lumin, që të vetëdijesohen dhe që të mos e ndotin atë.

- Modernizimi i sinjalistikës në qytet

Sinjalistikë moderne nënkupton edhe më shumë siguri për qytetarët

Në kuadër të projekteve të shumta në funksion të transformimit të Komunës sonë, kemi vendosur edhe shenjëzimin adekuat dhe vendosjen e sinjalistikës në rrugët e qytetit.

Përveç rritjes së vlerës estetike të zonës urbane, kufizimi i qartë i hapësirave të destinuara për të gjithë pjesëmarrësit në trafik do të shërbejë edhe për siguri më të madhe për të gjithë qytetarët që në vazhdimësi i frekuentojnë hapësirat publike.

- Mirëmbajtja e varrezave të veteranëve dhe të qytetit

Në vazhdën e mirëmbajtjes dhe pastrimit të varrezave të Komunës, do të përkujdesemi që të pastrohen dhe mirëmbahen rregullisht varrezat e veteranëve të Shtimes, por edhe të qytetarëve tanë që kanë ndërruar jetë.

- Rregullimi i Parkut dhe shtratit të lumit në Petrovë

Në vazhdën e punimeve dinamike që po kryhen, po sigurohemi për cilësinë në rregullimin e Parkut tek Lagjja Hysenaj në Petrovë ku po shtohen edhe hapësirat e gjelbra.

Gjithashtu, edhe për projektin e rregullimit të shtratit të lumi Shtimjanja parashihet që të bëhet vendosja e gurëve natyralë në një pjesë gjatësore të saj.

- Shkollat "Emin Duraku" në Shtime, "Hasan Prishtina" në Godanc dhe "Skënderbeu" në Reçak – përfituese të paisjeve mirëmbajtëse në vlerë 120.000 euro nga MASHT Shkollat fillore "Emin Duraku" në Shtime, "Skenderbeu" në Reçak si dhe "Hasan Prishtina" në Godanc, nga Ministria e Arsimit kanë përfituar pajisje të mirëmbajtjes në vlerë 120.000 euro për të trija shkollat. Pamjet janë nga vizita që e kemi realizuar në këto shkolla për t'i uruar përfitimin e këtyre pajisjeve kaq të nevojshme për mirëmbajtjen e shkollave.

- Lansimi i projektit përfitimin e vajzave në futboll

Vajzat të KFV "Prishtina" mund të ndjekin stërvitjet tri herë në javë në fushën e futbollit në Shtime. Çdo të premte, vajzat e Prishtinës dhe ato të Komuna Shtime do të stërviten së bashku në Shtime.

- Shpërndarja e 400 pakove ushqimore dhe përfitimin e familjet në nevojë Me mbështetjen e organizatës "Qatar Charity" kemi shpërndarë 300 pako ushqimore përfitimin e familjet në nevojë.

Ky aktivitet bamirësie u realizua me qëllim të ndihmës përfitimin e familjeve si raste sociale.

Do t'i vazhdojmë bashkëpunimet tonë me organizatat humanitare përfitimin e familjeve si raste sociale.

- Rivitalizimi i plotë i rrugës "Isa Boletini"  
Kjo rrugë u asfaltua në gjatësi totale prej 500 metrave, që ndërlidh çerdhen "Albiona Asllani" dhe SHML "Naim Frashëri", është rivitalizuar duke lehtësuar frekuentimin e përditshëm në këto dy institucionë edukativ-arsimore.

- Përrimin e Parkut në Davidovc  
Pasnesë, bashkë me Kryeministrin e Republikës së Kosovës, z. Albin Kurti me Ambasadorin e Gjermanisë në Kosovë, z. Jorn Rohde dhe me një delegacion gjerman do ta përrojë parkun në fshatin Davidovc në vlerë 200 mijë euro.

- Shtrirjen e rrjetit të Kanalizimit Fekal në Petrovë  
I kemi përfunduar punimet në shtrirjen e rrjetit të Kanalizimit Fekal në Lagjen "Ademaj"- Petrovë, me gjatësi rreth 800 metra.

Ky projekt në vlerë 23.000€ do të zgjidh problemin e banorëve që janë përballur me bllokimin e daljen e ujërave të zeza në sipërfacën e kullotave dhe natyrës së gjelbëruar.

Investimet infrastrukturore që përmirësojnë jetën e qytetarëve, do

vazhdojnë në secilin fshat e lagje që ka nevojë.

- Rivitalizimi i plotë i rrugës "Isa Boletini"

Në kuadër të angazhimit tonë për infrastrukturë të qëndrueshme dhe moderne, kemi rivitalizuar në tërësi rrugën e rëndësishme lokale "Isa Boletini".

Kjo arterie që për destinacion ka dy institucione edukativo-arsimore si çerdhen Albiona Asllani dhe shkollën e mesme Naim Frashëri është tejet e frekuentueshme dhe ka qenë nevojë serioze për kalimtarët dhe shfrytëzuesit e saj të përditshëm.

Në gjatësi prej 450 metrash dhe me gjerësi 5 metra, jemi përkujdesur që standardi i kësaj rruge të jetë maksimal dhe ky parim do të jetë i përhershëm, për secilin projekt.

Rruga e rivitalizuar do të pajiset me të gjitha nevojat infrastrukturore përcjellëse që do ta përmbushin nivelin më të mirë për të qenë rrugë solide dhe moderne.

- Shtigjet për ecje në rrugën Rashincë-Gllavicë në vlerë 50.000 euro

Kemi nënshkruar Marrëveshje e Mirëkuptimit me Ministrinë e Zhvillimit Rajonal në Programin për Zhvillim Rajonal 2023 përmes të cilit do të realizohen projektet "Rregullimi i shtigjeve të ecjes, çiklizmit dhe ndriqimit publik në Rashincë dhe Gllavicë".

Pyetje nga qytetarë:

**Ramadan Qeriqi:** Me ujësjellës çka i ka punët Shtimja dhe qendrës së Shtimes a keni menduar se si si me ja lanë emrin/ Shtimja a ka çerdhe?

**Qemajl Aliu:** Ujësjellësi është komplet çështje e KUR "Prishtina". Inxhinierët e KUR "Prishtina" në Shtime e kanë bërë një projekt ku do të hapen dy puse të reja. Sa i prket erdheve ne jemi në përgatitje për hapjes së tri çerdheve për të cilat e kemi marrë stafin e nevojshëm në punë dhe kjo është çështje e zgjidhur.

**Behadin Rexhepi:** Kam një sugjerim për zhvillimin e turizmit rural, e kisha propozuar rregullimin e ujëvarës së Mollopolcit, pastaj e kemi Spitalin Ushtarak në Topillë, Shpellën e Imer Devetakut, i cili është hero i kombit. A është biseduar ndonjëherë për impiantin ngase ujërat e zeza derdhën në lum dhe është rrezik për florën dhe faunën?

**Qemajl Aliu:** Ne e dimë që kemi nevojë për turizëm rural por njëherë jemi duke investuar në vendet me prioritet. Për Spitalin Ushtarak në Topillë tashmë kanë filluar punët për këtë çështje. Për ujërat e zeza më herët është marrë një kredi e butë nga Austria. Punimet e këtij konserceumi austriak e kanë qenë jo të mira dhe nuk është funksional. Ministria e Financave njëherë e ka ndërprerë këtë projekt por në të ardhmen do të zgjidhet edhe kjo çështje.

**Lulzim Balaj:** A ka ndonjë investitim përfshatin Carralevë?

**Qemajl Aliu:** Ky është raport për periudhën e parë gjashtëmuajore të këtij viti por në gjashtëmuajrin e dytë do të ketë investime edhe në fshatin Carralevë.

**Zhaneta Demiri:** Kërkoj që ndarja e subvenconeve të bëhet në bazë të rishikimit të projekteve mirë e jo pa asnjë mbikëqyrje.

**Qemajl Aliu:** Pyetja është me vend Zhaneta. Sa i përket ndarjes së subvencioneve për OJQ-të do të këqyrim projektet e tyre dhe më nuk ka mjete bllanko.

**Ibrahim Bungu:** Lumi që është duke u pastru më shumë është duke u dëmtuar trotuari sesa që është duke u pasturar lumi!



**Qemajl Aliu:** Sa i përket pastrimit të lumit, kontraktori është i obliguar që dëmet që i shkakton është i obliguar t'i riparon dhe kthen në gjendjen e mëparshme.


**Hysen Hoxha:** Në lagjen time në Gjurkovc nuk funksionon ujësjellësi, ndërsa Kompania të hollat imbledh nga qytetarët pa i kryer shërbimet ndaj qytetarëve. Po ashtu, menaxhimi I bërllokut nuk është i mirë.

**Veli Kelmendi:** Infrastrukturën në Karaqicë e kemi keq ngase tri lagje nuk janë lidhur ndërmjet vete. Vetëm një lagje është e lidhur. Një otrinë e katunit i është dhënë një investitori dhe mua ma ka pre ujin.


Procesmbajtëse: Gentiana Mehmeti











LISTA E PJESEMARRIVE NË MILEODHËN PUBLIKË ME QYTETARE Shtime, më 30 qershor 2023			
Nr.	Vetëvlerje	Vendndodhje	Mesazhi
1	Slobodan Begaj	Shtime	Begaj
2	Rustemi Dervish	Shtime	Dervish
3	Fazlija Caka	NDRKSH-jaqen	Caka
4	Gjelica Çani	CAKRIVIC	Çani
5	Ajzeni Çekuri	CAKLLAVE	Çekuri
6	Bajram Ilaz	Gjyktues	Ilaz
7	Hekurri Sejdiu	Murgimi	Sejdiu
8	Alba Hoxha	Kosovice	Hoxha
9	Adem Hoxha	Kosovice	Hoxha
10	Petritra Kukeli	Kosovice	Kukeli
11	Damata Kushta	Kosovice	Kushta
12	Vakila Kushta-Jasmi	Kosovice	Kushta
13	Gjin Hoxha	KATNIQ	Hoxha
14	Egzon Pushtin	PASING	Pushtin
15	Saimir Shala	Petëma	Shala
16	Luanë Ahmeti	Petëma	Ahmeti
17	Shane NIKITA N.	Godranc	Nikita
18	Egzon Selmani	Shtime	Selmani
19	Khastim Bala	SHTIME	Bala
20	Breda Novaci	Shtime	Novaci

Blindra Demir	Shtime	Demir
Flati Hysniçaj	Petrovic	Hysniçaj
R. Jashari	Shtime	Jashari
Osvaldo Llukasi	Gjilanë - Fushë	Llukasi
Ezron Gazi	Shtime	Gazi
Osman Hamza	Shtime	Hamza
Zefende Korkuf	Kosovë	Korkuf
Cemre Hoxha	Gjilani	Hoxha
Elinde Oftiro	Dardar	Oftiro
Hoxurri Hoxha	SHTIME - FERDANI	Hoxha
Hoxurri Kushta	SHTIME	Kushta
Egzon Bajraktari	SHTIME	Bajraktari
Naseri Hoxha	Gostivar	Hoxha
Gjumbe Beqiri	SHTIME	Beqiri
Osmane Suharevi	SHTIME	Suharevi
Arben Ruzdiqi	SHTIME	Ruzdiqi
Hekurri Nira	Shtime	Nira
Hil Reça	Petrovo	Reça
Egzon Fazliu	Shtime	Fazliu
Abdullah Topalli	Shtime	Topalli
Hoxurri Kukeli Kukeli	Shtime	Kukeli
Gjergji Bishimi	26ore	Bishimi
Lulzim Salihu	Shtime	Salihu